



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina**



24 / 07 /2019

**PJESA I E KONTRATËS:**      **KONTRATA**

**KOMUNA E PRISHTINES**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njérën anë; dhe

**OE: "Rexha Shpk , adresa - Prishtine** me numër te regjistrimit te biznesit dhe numër fiskal 810515223, përfaqësuar nga Samir Rexha-drejtor (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:

**Tituli: "Ndertimi i rruges Dabishevc- Mutivod" – LOT 4**

Me numër identifikues: **Nr. 616 19 033 511**

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit "Ndertimi i rruges Dabishevc- Mutivod" sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Vendi i kryerjes së punimeve është **ne Dabishevc –Mutivod**. Fillimi i realizimit të kësaj kontrate do të bëhet nga dita e caktuar në planin e menaxhimit të kontratës për fillim të punimeve, ndërsa afati kohor për përfundimin e punimeve është **60 ditë kalendarike** nga dita e caktuar në planin e menaxhimit të kontratës për fillim të punimeve, i cili do të konstatohet sipas ditarit të punës.

**Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **134.818,00 € (Njeqind e tridhjete e katërmijë e tetëqind e tetembredhjetëeuro e zero eurocent)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione. Situacionet paguhen pas përfundimit të punëve në vlerë prej **50,000.00 €** apo edhe me tepër me konstatim nga menaxheri dhe organi mbikëqyrës i projektit i caktuar me vendim nga ZKA.

Pagesa e fundit, e cila nuk mund të jetë më pak se 10% e vlerës së kontratës, do të bëhet pas përfundimit të punimeve të kontraktuara, bazuar në raportin përfundimtar dhe lëshimin e certifikatës për kryerjen e punëve nga personat e autorizuar – menaxheri apo ekipi për menaxhim të kontratës, në harmoni me dispozitat ligjore dhe kushtet e kësaj kontrate. Çdo pagesë duhet të aprovohet nga Zyrari i Prokurimit dhe i financave të Autoritetit Kontraktues.

**Neni 3 Rendi i përparsësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparrësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


#### Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rr Ethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe** në katër origjinalë, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për kontraktuesin
<b>Emri:</b>	Zekë Bardhaj	<i>FATMIRE CANOLI</i>
<b>Pozita:</b>	Udhëheqës i prokurimit	<i>ZYRTARE E FINANCAVE DHE PROKURIMIT</i>
<b>Nënshkrimi:</b>		
<b>Data:</b>	07.04.2019	07.04.2019
<b>Vula:</b>		

## 1. PJESA II E KONTRATES

## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grapi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuar nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvçe në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvçe në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me

rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkizazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, i' transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

#### **Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

##### **Neni 5                    Dhënia e dokumenteve**

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë ne dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe përkompensem dëmi nga ndonjë defekt të saj.

##### **Neni 6                    Qasja në vend punishte**

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrate të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre originale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

##### **Neni 7                    Ndihma lidhur me rregulloret vendore**

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues përmarrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit përfamiljet e tyre.

#### **Obligimet e Kontraktuesit**

##### **Neni 86                    Obligimet e Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtjerë fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu eksposuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i

urdhrit administrativ nuk do tē pezullohet pēr shkak tē këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe tē veprojë sipas tē gjitha ligjeve dhe rregulloreve nē fuqi nē Republikën e Kosovës dhe do tē sigurojë që personeli i tij, tē afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë tē tij gjithashtu t'i respektojnë dhe tē veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë tē gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç nē rastet kur kjo është e nevojshme pēr qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do tē publikojë ose shpalosë asnjë detaj tē kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do tē ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim tē Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do tē siguroj se punët do tē fillojnë dhe tē përfundojnë brenda asfatit tē caktuar rënë dakord nē programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do tē siguroj që tē gjitha punët që ai/ajo do tē bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do tē bëhen nē kohë dhe nē përputhje me standartet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe pēr më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do tē pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë tē ngashme.

8.7 Kontraktuesi do tē siguroj pēr cilësinë e punës dhe pēr cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë pērdorur pēr realizimin e punëve tē kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet tē siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës pēr arsyet e mëposhtme:

- në qofte se pēr kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë tē llojeve tē ndryshme, vinça, kamionë tē llojeve tē ndryshme, skela tē larta, etj do tē përdoren dhe
- në mënyrë që tē mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do tē jetë përgjegjës pēr sigurinë e tē gjitha aktivitetave nē vend punim.

#### Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet tē punësoj personel kyç dhe tē pērdor pajisje tē identifikuara nē tender e tij, pēr tē kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje tē aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do tē aprovoj çdo zëvendësim tē propozuar tē personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë nē thelb tē barabarta ose më tē mirë se ato tē propozuara gjatë tenderit.

#### Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do tē, jo më vonë se dita e nënshkrimit tē kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pēr ekzekutim tē plotë dhe tē mire tē kontratës. Shuma e sigurisë do tē saktësohet nē KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pēr çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit tē plotë dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do tē vazhdoj tē mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit te Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit tē kontratës do tē jetë nē formën e dhënë nē pjesën IV tē kontratës.

#### Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa tē lëshohet Certifikata e Korrigimit tē Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet tē siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri nē fund tē periudhës garantuese tē defekteve nē shumat e përcaktuara nē KVK pēr ngjarjet e mëposhtme tē cilat janë pēr shkak tē rreziqeve tē Kontraktuesit:

- humbe ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- humbe ose dëmtim i Pajisjeve;
- humbe ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) nē lidhje me Kontratën; dhe
- dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit tē kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën pēr sigurim që ka pēr qëllim kompensimin e nevojshëm pēr tē siguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyё të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e asfatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe të zgresë çmimin e shpërbimit nga fitimi i kontraktuesit.

#### **Neni 12 Programi**

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do te përmbarje se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e përgjithshme që do ti zbatoje, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'i ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të tris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

#### **Neni 13 Siguria në vend-punishte**

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahan. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë te cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrate ose që me arsyë mund të kërkojen nga Autoriteti Kontraktues

#### **Neni 14 Ndërhyrja me trafikun**

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tillë si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

#### **Neni 15 Tatimi**

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

#### **Neni 16 Kostoja e Riparimeve**

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

## FILLIMI DHE VONESAT

### Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

### Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyë:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjeter ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

### Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumë e përeactuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shakat të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

## Materialet dhe mjeshtëritë

### Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvèç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësisht të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se

Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistr. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

#### **Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve**

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekt i një kërkese të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkësë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

#### **Neni 22 Inspektimi dhe testimi**

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj “Menaxherin e Projektit”, të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për tij lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsy përvonesë në përbushjen e detyrate.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, qe të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritisë se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimi.

#### **Neni 23 Paralajmërim i hershëm**

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

## PAGESAT

### Neni 24

### Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikatë. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhën nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjtë formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

### Neni 25

### Paramasa dhe Parallogaria

25.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

### Neni 26

### Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

### Neni 27

### Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion barakar “me kërkeshë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

## Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

## Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bëre në përputhje me konratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet si paguhet sipas kontratës; dhe
- pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

## Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- Kontraktuesit tjérë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- Parapagimi vonohet.
- Menaxheri i Projektit pa arsyë të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit përmbytje të kontratës.
- Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërcësës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvèç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshteria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjeter për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostojë e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojet Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

#### Shkelja e kontratës dhe shkëputja

##### Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

##### Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjeter shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenen punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyё të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjeter nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajt të palës së tretë krijohen rrithana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimesin e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### Neni 38                  **Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrrëgullimet industriale, çrrëgullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikuesme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësítë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësítë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

#### Neni 39                  **Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KV. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

#### Neni 40                  **Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### Neni 41                  **Lirim i Ekzekutimit**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres

punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### PJESA III E KONTRATES

#### kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amendamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>10% e vleres se kontrates, me garancion bankar nga një bankë e licencuar ose kompani sigurimesh e licencuar nga BQ e Kosovës ne afat prej 90 dite kalendarike.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjëri në koston e zëvendësimit të plotë;</li> <li>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</li> <li>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</li> <li>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</li> </ul> </li> </ul>

		e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>15 dite pas nënshkrimit te kontratës</b> .
	17.2	60 dite kalendarike
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.
Registri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do te përcaktohet pas nënshkrimit te kontratës me vendim nga ZKA
Pagesat	24.1	<p>Pagesat do të bëhen në euro.</p> <p>Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione. Situacionet paguhen pas përfundimit të punëve në vlerë prej <b>50,000,00 €</b> apo edhe me tepër me konstatim nga menaxheri dhe organi mbikëqyrës i projektit i caktuar me vendim nga ZKA.</p> <p>Pagesa e fundit, e cila nuk mund të jetë më pak se 10% e vlerës së kontratës, do të bëhet pas përfundimit të punimeve të kontraktuara, bazuar në raportin përfundimtar dhe lëshimin e certifikatës për kryerjen e punëve nga personat e autorizuar – menaxheri apo ekipi për menaxhim të kontratës, në harmoni me dispozitat ligjore dhe kushtet e kësaj kontrate. Çdo pagesë duhet të aprovohet nga Zyrtari i Prokurimit dhe i financave të Autoritetit Kontraktues.</p>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <b>nuk ka pagesë paraprake</b>
Mbajtja e Parasë	27.1	<p>Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës.</p> <p>Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 te KPK.</p>

		Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar “me kërkesë” ose nga një kompani e sigurimeve e licensuar. Shuma e parave te mbajtura do te mbahet gjate tere periudhës se defekteve: per 5 vite
Shkaqet kompensim për	30.1	
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet përvlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin përkompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>[a] Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë</b> në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>

Kekli Lotu

### "Ndërtimi i rrugës Dabishevë-Motivodë" fazë e dytë

#### Rruga

**Km 0+000.00 - 1+860 m**

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Cmimi njësi	Cmimi total
<b>1 INCIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN</b>					
1.1 Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontroll të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në rrugë.					
1.2 Vendosja e dhe sigurimi i pikave te reja poligonale per percjellje te puneve gjedezike ne teren.	m'	1860	0.50	930.00	
1.3 Shenimi i trasës si dhe percjellja e punimeve gjedezike gjatë ekzekutimit.	m'	1860	0.50	930.00	
<b>2 PUNËT TOKËSORE</b>					
2.1 pastrimi i kanalit përlargimin e ujave atmosferike, ngarkimi dhe transporti i materialit deri në 1km pasrëmi i lëshesave gypore te kokat hyrëse dhe dalëse si dhe mbrenda gypave, lëshesat ekzistuese prej gypave të betonit me diametër Ø400-Ø1000 të cilat kanë gjatësi prej 4-10m,transporti i materialit deri në 1km	m'	1860	1.50	2,790.00	
2.2 Planifikimi me grejder dhe ngjeshtja e trupit te rruges me ngjeshmeri 60MN/m <sup>2</sup>	copë	14	28.00	392.00	
2.3 Planifikimi me grejder dhe ngjeshtja e trupit te rruges me ngjeshmeri 60MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	13020	0.70	9,114.00	
<b>3 KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS</b>					
3.1 Shqyrtimi i të gjitha prova per te gjitha shiresat e rruges ne laborator sipas kerkeses se investitorit(shpreses stabilizuese, Tampon 0-60, Tamponit 0-30, Dy shtresave te asfaltit etj..)	m'	1860	0.20	372.00	
3.2 Furnizimi,planifikimi dhe ngjeshtja e tamponit fr.0-63mm (90MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëllqeror për sanitimin e trupit të rrugës.	m <sup>3</sup>	250	11.00	2,750.00	
3.3 Furnizimi,planifikimi dhe ngjeshtja e tamponit fr.0-31.5mm (100MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëllqeror me trashësi t=10cm	m <sup>3</sup>	1302	11.00	14,322.00	
Furnizimi,transporti,planifikimi dhe ngjeshtja e bituzhavorit 0-22mm me trashësi t=7cm i përzier me përfocues të asfaltit me përbërje të fibrave të Aramidit dhe Polyolefineve, njëjtë sikurse Forta- Fi ose ekivalent me Forta Fj) ose materiale të tjera me përbërje dhe karakteristika të njëjtë (500 gr/l ton asfalt).	m <sup>2</sup>	9300	7.00	65,100.00	
<b>4 SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL</b>					
				<b>Gjithsej 4:</b>	<b>82,544.00</b>

4.1	Furnizimi dhe vendosja e vijës së mesit te rruges me gjeresi 0.10m	m'	2426	0.80	1,940.80
4.2	Furnizimi dhe vendosja e shigjetave orientuese te qarkullimit, me gjatesi 5 m	copë	10	25.00	250.00
4.3	Furnizimi dhe vendosja ( përfshirë të gjitha operacionet e vendosjes) e shenjave të trafikut në formë trekëndëshe	copë	3	40.00	120.00
4.4	Furnizimi dhe vendosja e shenjave të trafikut në formë rrethore	copë	17	40.00	680.00
4.5	Furnizimi dhe vendosja e shenjave të trafikut në formë drejtëkëndëshi me dimensione të specifikuara	copë	5	50.00	250.00
4.6	Furnizimi Transporti dhe vendosja në vepër e pahive elastike standarte tip B e njëfishët	m'	450	22.00	9,900.00
				Gjithsej:	<u>13,140.80</u>

Verejtje: Shenjat horizontale duhet te punohen nga masat e perziera plastike dy komponenteshe me perberje te grimcave fluorescente

#### REKAPITULLIMI

1	INCIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN	3,348.00
2	PUNËT TOKËSORE	12,296.00
3	KONSTRUKSIONI TRASËS SË RRUGËS	82,544.00
4	SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL	13,140.80
		Gjithsej: 111,328.80

Nr. rendor	Uloji i punës	PUNËT PARAPRAKE			
		Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
<b>1</b>					
1.1	Shenimi i trasës para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit (Sipas Projektit).	m'	211	2.00	421.14
1.2	Hartimi I projektit të ekzekutuar pas perfundimit të punimeve, (aty ku projekti ka pësuar ndryshime).	m'	211	1.20	252.68
1.3	Prerja e shkurreve dhe drunjëve per gjatë rrugës, dhe largimi i tyre deri në deponi.	m'	125	2.00	250.00
1.4	Demolime I materialeve të ngurta si beton, asfalt dhe materiale tjera duke përfshir edhe transportin deri në deponi.	m³	1	15.00	15.00

<b>1.5</b>	Demontimi i rrëthojave prej telli me gjemba dhe kthimi i tyre në gjendjen e mëparshme pas perfundimit të projektit.	m'	210	2.00	420.00
<b>1.6</b>	Demontimi i lëshesave egzistuese me $\Phi 60 \cdot \Phi 100\text{cm}$ dhe gjatësi $L=3\text{-}8\text{m}$ dhe kokave hyrse, dalsë të lëshesave duke perfshirë edhe transportin deri në deponi.	copë	1	15.00	15.00

**PUNET PARAPRAKE**

**GJITHSEJ:**

**1,373.82**

**PUNIMET E DHEUT**

<b>2</b>	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe deponi në largësi 15km.	V-të me ngarkim dhe bartje deri në modulin e ngjeshtmerisë	m³	525	3.00	1,575.00
<b>2.1</b>	Grryerja, planifikimi, rrashimi i nënbaçës dhe ngjeshtje deri në modulin e ngjeshtmerisë	m²	1050	0.90	945.00	
<b>2.2</b>	25N/mm²	m²	1155	0.80	924.00	
<b>2.3</b>	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m²	m³	315	8.00	2,520.00	
<b>2.4</b>	Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushes guror jokoherent me CBR>20%, shtrirje dhe ngjeshtja në shresa jo më të madha se 30cm deri në modulin e ngjeshtmerisë 45MN/m²	m³	63	11.00	693.00	
<b>2.5</b>	Furnizimi, transporti dhe punimi i bankinës prej materialit guror me fraksion 0/32mm.	m³	210	1.50	315.00	
<b>2.6</b>	Hapja e kanaleve të ujраве atmosferike duke perfshirë hapjen dhe formsimin e tyre.				<b>6,972.00</b>	

**PUNIMET E DHEUT**

**MBISTRUKTURA**

<b>3</b>	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshtja e tamponit ( $70\text{MN}/\text{m}^2$ ) prej gurit të thyer gëqeror, 0-60mm me trashësi $t=20\text{cm}$	m³	210	11.00	2,310.00
<b>3.1</b>	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe ngjeshtja e tamponit ( $90\text{MN}/\text{m}^2$ ) prej gurit të thyer gëqeror, 0-31mm me trashësi $t=10\text{cm}$	m³	95	11.00	1,039.50
<b>3.2</b>	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltit binder BZH 22 me trashësi $t=8,0\text{cm}$ duke inkorporuar edhe shtrresen e parë emulsionit prej $03\text{kg}/\text{m}^2$ .	m²	903	8.00	7,224.00
<b>3.3</b>	Furnizimi, transporti dhe vendosje e rigollave standarde nga betoni të markes C30/37 te resistueshem ngricave me gjersi $t=70\text{cm}$ .	m'	15	5.00	75.00
<b>3.5</b>					<b>10,648.50</b>

**GJITHËSEJ PUNËT E MBISTRUKTURES**

<b>4</b>	Lëshesat Rethore				
<b>4.1</b>	Gërmimi i dheut të kater: III dhe IV në thelli 0-3m per vendosjen e lëshesave.	m³	185	3.00	555.00
<b>4.2</b>	Furnizimi, Shtruerja dhe kompaktimi i zhavorit si bazë vendosjes së themelive të lëshesave	m³	19	11.00	209.00

<b>4.3</b>	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe me koka hyrëse-dalëse si dhe perforsim nga betoni, punimi komplet duke perfsirë betonin dhe armimin sipas detaleve në projekt.					
<b>4.4</b>	Furnizimi, transporti dhe punimi i lëshesave monolite ose montazhe me koka hyrëse-dalëse, punimi komplet (kryqezimet me rruge lidhese) Ø 500mm.	m'	72	32.00	2,304.00	

W  
W  
W

W  
W

3,528.00

## TË NDRYSHME

<b>5.1</b>	Furnizimi Transporti dhe vendosja në vepër e pahive elastike standarde tip B e njëfisht	m'	40	24.00	960.00	
		<b>GJITHSEJ PUNËT E NDRYSHME</b>			<b>960.00</b>	

## Paramasa me Paralogari

<b>1</b>	<b>PUNËT PARAPRAKE</b>		<b>1,373.82</b>	
<b>2</b>	<b>PUNIMET E DHEUT</b>		<b>6,972.00</b>	
<b>3</b>	<b>MBISTRUKTURA</b>		<b>10,648.50</b>	
<b>4</b>	<b>LËSHESAT RRETHORE</b>		<b>3,528.00</b>	
<b>5</b>	<b>TË NDRYSHME</b>		<b>960.00</b>	
<b>9</b>	<b>TOTALI ME (TVSH)</b>		<b>23,482.32</b>	

23,482.32  
23,482.32

## REKAPITULIM PER FUNDIMTAR

<b>1</b>	"Ndërtimi i rrugës Dabishevç-Motivodë" faza e dytë		
<b>2</b>	Ndërtimi i rruges ne Hajkobile, lagja Behluli		
<b>9</b>			
		<b>TOTALI ME (TVSH)</b>	<b>134,811.12</b>

134,811.12  
134,811.12

134,811.12  
134,811.12